



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SANJA A. TELHALLARI
ADRESA Njesia Administrative Kashar,
Unaza e Re, Rr. "Teodor Keko"
TEL: +355672022444

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME



Nr. repertori: 4962

Nr. koleksioni: 1900

Tirane më 02/04/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021052120126218163



A2021052120126218163



KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot, më datë ___/___/2021 (dymije e njezet e nje) para meje Notere **SANJA A. TELHALLARI**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Administrative Kashar, Unaza e Re, Rr. "Teodor Keko", u paraqit personalisht:

DHURUES:

Roland Veseli, atësia Mehmet, amësia Lumturi, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, me adresë Him Kolli; Nd. 00; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 03/03/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033620451 dhe nr. personal G90303198V, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")

PRANUES I DHURIMIT:

Mimoza Veseli, atësia Bajram, amësia Kumrije, shtetase Shqiptare, lindur në Krujë dhe banuese në Tiranë, me adresë Him Kolli; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 02/01/1971, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035234699 dhe nr. personal H15102140K, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

Baza Ligjore

- a. Neni 761 e vijues të Kodit Civil
 1. Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar
 2. Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- b. Shoqëria "A.M.U." sh.p.k (më poshtë referuar si "Shoqëria"), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT K14229210F, me seli ne Autostraden Fush Kruje - Lac, km 1.5, Durres, me një kapital prej 110.000.000,00 Lek (njeqind e dhjete milion), e ndarë në 1 (nje) kuote të zakonshme, me vlere nominale prej 110.000.000,00 (njeqind e dhjete milion) Lek kuota dhe sikurse rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar lëshuar nga QKR për të dhënat e Shoqërisë



A2021052120/26218163

- c. Dhuruesi zotëron 1 (nje) kuote te kapitalit te Shoqërisë, me vlere nominale prej 110.000.000,00 (njqind e dhjete milion) Lek, që përfaqëson 100% (njqind per qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë (në vijim "Ortaku");
- d. Njëpërmjet kësaj Kontrate Dhuruesi dëshiron t'i transferoje Pranuesit te Dhurimit 49 (dyzet e nente) % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ne vleren 53.900.000,00 Leke.
- e. Pranuesi i Dhurimit dëshiron te fitoje pronësinë mbi 49 (dyzet e nente) % Kapitalit te Dhuruesit, si me lart, ne vleren 53.900.000,00 Leke.
- f. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë, dhe pas miratimit të këtij transferimi sipas Vendimit të Asamblesë se Ortakeve te Shoqërisë, vendim i njohur dhe pranuar plotësisht nga Palët e qe i bashkëlidhet kësaj Kontrate, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

- 1.1. Njëpërmjet kësaj Kontrate Dhuruesi i dhuron dhe i kalon ne pronësi Pranuesit te Dhurimit dhe Pranuesi i Dhurimit pranon të fitojë dhe marrë në pronësi nga Dhuruesi gjithsej 49 (dyzet e nente) % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë ne vleren 53.900.000,00 Leke

Neni 2 Deklarimet dhe garancitë

- 2.2. Dhuruesi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron kuotat që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'i transferuar këto kuota dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.
- 2.3. Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Pranuesi i Dhurimit ka tagra të plota për të pranuar aksionet nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi i Dhurimit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi i Dhurimit.

Neni 3 Transferimi i pronësisë mbi aksionet

- 3.1. Transferimi i pronësisë mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kryhet nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, meqenëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve të Shoqërisë ka dhe miratuar me Vendimin e saj, këtë transferim dhe ndryshimet e Statutit te Shoqërisë..
- 3.2. Pas transferimit të pronësisë mbi kuotat sipas kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kapitalit themeltar të Shoqërisë do të jetë si vijon:
 - Z.Mimoza Veseli behet zotëruese e **49 (dyzet e nente) %** te kapitalit themeltar te Shoqërisë ne vleren 53.900.000,00 Leke (1 kuote).
 - Z.Roland Veseli mbetet zotërues i 1(nje) kuote qe përfaqëson **51 (pesedhjet e nje) %** te kapitalit themeltar te Shoqërisë ne vleren 56.100.000,00 Leke (1 kuote).
- 3.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat e zotëruara në emër të tij në Regjistrin Tregtar



A2021052120126218163

pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4
Të ndryshme

- 4.1. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 4.2. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 4.3. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale.

Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e kalimit të të drejtave, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DHURUESI
Z.Roland Veseli

Roland Veseli

PRANUESI I DHURIMIT
Znj.Mimoza Veseli

Mimoza Veseli

NOTERE
SANJA A. TELHELLARI

V E N D I M

I ASAMBLESE SE ZAKONSHME TE ORTAKUT TE VETEM

Në selinë e shoqërisë, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "A.M.U." Shpk e rregjistruar në QKB në datën 01.02.2002 me numër identifikimi K14229210F me seli ne Autostraden Fush Kruje - Lac, km 1.5, Durres me veprimtari tregëtie me pjesmarrjen e:

- Roland Veseli zotërues i 1 (një) kuote me vlerë sa 100% të vlerës së kapitalit.

Rendi i ditës së mbledhjes është:

1. **Vendim per ndarjen e kapitalit ne 2 kuota**
2. **Vendimmarrje për dhurimin e 49% të pjesës së kapitalit themeltar të ortakut të vetëm.**

Mbledhjen e fillon z. Roland Veseli i cili është ortak i vetëm i shoqërisë i cili shpreh vendimin e tij për me vlere te kuotave 49% dhe vlere kapitali 53.900.000,00 Leke të ortakut në shoqërinë " A.M.U "Shpk.

Në përfundim pas shqyrtimit të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të shoqërisë, me cilesine e Ortakëve të Shoqërisë, bazuar ne Statutin, Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për QKB" i ndryshuar, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë:

V E N D I M:

1. Të dhurojë 49% të aksioneve dhe vlere kapitali 53.900.000,00 Leke. për znj. Mimoza Veseli
2. Pas dhurimit të pjesëve të kapitalit Shoqëria me ortak të vetëm dhe një kuotë do bëhet me dy ortak dhe me 2 (dy) kuota.
3. Palët të lidhin kontratë dhurimi për të caktuar termat vijues të shitje dhurimit të kuotave aksionare.
4. Vendimi dhe ndryshimet të depozitohen dhe të regjistrohen në QKB.


ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM

Ortaku:

Roland Veseli

Roland Veseli
[Signature]






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K14229210F	
2. Data e Regjistrimit	01/02/2002	
3. Emri i Subjektit	A.M.U	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	05/10/2001	
6. Kohëzgjatja	Nga: 05/10/2001	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durrës Fushe Krujë FUSHE KRUIJE Autostrada Fushe Krujë - Laç, km 1.5.	
8. Kapitali	110.000.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Tregtimi i materialeve te ndryshme per ujesjellesa, gazsjellesa dhe sisteme vaditjeje, si edhe kryerja e punimeve ne kete fushe. Tregtim i materialeve elektrike dhe elektronike, si edhe realizimi i punimeve ne kete fushe. Sherbim / riparim i makinave elektrike dhe i transformatoreve elektrik (elektropompa, elektromotor, transformator). Punime alumini, metali, ndertimi dhe montimi. Çdo aktivitet tjeter ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem per realizimin e qrlimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi. Importim dhe tregtim me shumice dhe pakice e pijeve, lengjeve dhe produkteve ushqimore te ambalazuara. Tregtimi i kasetave te matesave te ujit, punime metalike, konstruksione metalike, kaseta elektrike.	
10. Administratori/ët	Mimoza Veseli	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 02/10/2018	Deri: 02/10/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	Administartore me te drejta te vetme per te bere veprime ne	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	banka, per te aplikuar per dokumenta.	
12. Administratori/ët	Roland Veseli	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 08/02/2021	Deri: 08/02/2026
13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
14. Ortakët	Roland Veseli	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 110.000.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Kashar YZBERISH Lagjja Yzberish, Rruga Sokrat Miha, Kompleksi Fratari, Godina nr 4, dyqani nr 8	
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: A.M.U E-Mail: amu@amu.al Telefon: 042267671 Të Tjera: U Dorzua Bilanci I Vitit 2007. Depozitim i vendimit Nr.1 Date 29.06.2009 me Nr. prot.16	
17. Statusi:	Aktiv	

Datë: 02/04/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)